



Në mbështetje të nenit 64.2, pika (a) dhe (b), nenit 44 dhe 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) si dhe nenit 17, 20 dhe 29.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZK) dhe Ligjit Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, dhe Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023 miraton këtë:

RREGULLORE NR. 07/2023

FUSHATA E ZGJEDHJEVE DHE NJOFTIMI PËR NGJARJET POLITIKE

Neni 1

Fushëveprimi

Kjo Rregullore përcakton procedurat mbi organizimin dhe mbajtjen e tubimeve publike, të drejtat e subjekteve politike gjatë fushatës, përmbajtjen e materialeve të shtypura të fushatës zgjedhore, rastet e veprimeve para ditës së zgjedhjeve, rolin e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), rolin e pjesëtarëve të sigurisë gjatë tubimeve publike, veprimet e ndaluara dhe sanksionet.

Neni 2

Organizimi dhe mbajtja e tubimeve publike

1. Subjekteve politike të certifikuara u ndalohet t'i mbajnë tubimet publike brenda hapësirës që shfrytëzohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet dhe agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës, ashtu siç përcaktohen në Kreun XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përveç në shkolla, pas orarit të mësimi.
2. Subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim në KKZ apo në mënyrë elektronike, shtojca I - Formulari për tubime publike, jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë përpara kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit.
3. KKZ, pas pranimit të formularit nga subjekti politik, e regjistron në libër të protokollit dhe vendos për miratim në bazë të datës dhe kohës së pranimit të njoftimit. KKZ, jo më vonë se ora 09:00 e ditës së tubimit e njofton policinë.
4. KKZ mund të refuzojë kërkesën e subjektit politik, në rast se hapësira është e zënë sipas nenit 3 të kësaj Rregulloreje dhe e njofton subjektin politik për refuzimin e kërkesës.
5. Subjekti politik i certifikuar që ka marrë përgjigje negative nga një KKZ në kërkesën për

mbajtjen e tubimit publik, sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje, mund të ushtrojë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP.

6. Subjekti politik i certifikuar do ta mbajë tubimin publik, duke i respektuar të gjitha parimet ligjore me të cilat rregullohen tubimet publike.
7. KKZ është përgjegjës të mbajë koordinim të vazhdueshëm me policinë dhe të sigurojë informim të ndërsjellë për çdo shkelje eventuale të Kodit të Sjelljes sipas Kreut të V të LZP nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre gjatë tubimeve publike. Raportet e policisë në lidhje me prishjen e ndonjë ngjarje politike i vihen në dispozicion KQZ dhe PZAP. Çdo shkelje duhet që menjëherë të raportohet në PZAP për veprim të mëtejshëm nga ana e tyre.
8. Subjekti politik është i obliguar të njoftojë KKZ për anulimin e tubimit të paralajmëruar.
9. Diferenca në kohë në mes të dy tubimeve në të njëjtin vend, duhet të jetë së paku dy 2 orë.

Neni 3

Të drejtat e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve politike

1. Gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve, subjektet politike të certifikuara kanë të drejtë të:
 - 1.1. Organizojnë dhe mbajnë tubime publike, tryeza të rumbullakëta, konferenca për shtyp, intervista, fjalime ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, nëpërmjet të cilave ata mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre, me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre;
 - 1.2. publikojnë dhe shpërndajnë afishe, reklama dhe material tjetër, lidhur me një fushatë zgjedhore;
 - 1.3. të bëjnë fushatë përmes cilitdo operator televiziv dhe të radios, gjithashtu edhe përmes revistave, shtypit, rrjetit telefonik, sistemit postar, rrjeteve sociale ose çdo lloj mjeti tjetër reklamues;
 - 1.4. subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtim me rregullat zgjedhore të KQZ, kodin e mirësjelljes të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) dhe Ligjit për Financim të Subjekteve Politike (LFSP).
2. Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar, nuk mund të përfshihen kategoritë, si në vijim:
 - 2.1. Të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike, gjatë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, të cilët pezullojnë vendin e punës;
 - 2.2. pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës;

- 2.3. pjesëtarët e uniformuar të Policisë së Kosovës dhe personeli i tyre, përveç kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare;
 - 2.4. të punësuarit në organizatat bamirëse dhe fetare;
 - 2.5. përfaqësuesit e bashkësive fetare;
 - 2.6. anëtarët e KQZ, stafi i SKQZ dhe KKZ, përveç në rastet kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare.
3. Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të përfshijë personat të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjet, në veprimet e mëposhtme:
 - 3.1. Të vendosin postera dhe shpërndajnë materiale tjera promovuese;
 - 3.2. të jenë pjesë aktive e fushatës dhe materialeve promovuese politike, përveç me prindërit e tyre;
 - 3.3. të përdoren si sfond/prapavijë, në mënyrë të organizuar, të pa shoqëruar nga prindërit e tyre, në këmbë apo ulur, gjatë emisioneve apo aktiviteteve tjera të ngjashme të fushatës zgjedhore.
 4. Personave të moshës gjashtëmbëdhjetë (16) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç, ju lejohet përfshirja në aktivitetet e fushatës, vetëm me vullnetin e tyre dhe pas orarit të mësimave.

Neni 4

Tubimet e paautorizuara publike

Çdo tubim publik i mbajtur pa e dorëzuar kërkesën apo pas refuzimit të saj nga KKZ ose policia, do të konsiderohet i paautorizuar dhe në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 5

Materialet e fushatës së zgjedhjeve

1. Të gjitha materialet e shtypura, ato audiovizuale dhe materialet e tjera të zgjedhjeve, përfshirë ato online, duhet ta mbajnë emrin e subjektit politik të certifikuar që e ka porositur përgatitjen e materialit të tillë.
2. Materiali i subjekteve politike nuk duhet të vendoset brenda hapësirës së institucioneve publike, shkollave, objekteve fetare, objekteve në pronësi shtetërore, në monumente, ndërtesa, struktura dhe objekte të cilat kanë vlerë historike, kulturore, fetare ose arkitekturore, brenda ndërtesave dhe zyrave të KQZ apo të KKZ dhe brenda qendrave të votimit, ose në një largësi prej më pak se njëqind (100) metra nga hyrja e tyre.
3. Materialet e shtypura të zgjedhjeve, mund të ekspozohen brenda objekteve në pronësi

private, ndërtesave, strukturave, ose objekteve të tjera, përveç atyre të saktësuara në paragrafin 2 të këtij neni, pas miratimit paraprak të pronarëve të tyre.

4. Cilido subjekt politik i certifikuar lejohet të ekspozojë materialin e vet të zgjedhjeve në atë mënyrë që, të mos e pengojë pamjen e materialeve të zgjedhjeve që u përkasin subjekteve të tjera politike të certifikuara.
5. KKZ duhet që aktivisht ta monitorojnë shfrytëzimin e materialeve të shtypura, atyre audiovizuale dhe të çfarëdo materiali tjetër të zgjedhjeve të subjekteve politike të certifikuara, gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve. Në rast të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për zgjedhjet, ose të dispozitave të përcaktuara me LZP apo rregulloret e KQZ, KKZ duhet që menjëherë ta informojnë subjektin politik në fjalë që të marrë masa korrigjuese. Nëse shkeljet përsëriten nga i njëjti subjekt politik ose i njëjti refuzon që t'i korrigjojë shkeljet e identifikuara, KKZ duhet ta raportojë rastin në PZAP.

Neni 6

Veprimet e ndaluara gjatë heshtjes zgjedhore

1. Gjatë periudhës 24-orëshe para hapjes së vendvotimeve për votim, e deri në mbylljen e vendvotimeve në ditën e zgjedhjeve (prej orës 07:00 të ditës së shtune deri në ora 19:00 të dielës në ditën e zgjedhjeve, subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohet kryerja e çfarëdo aktiviteti që lidhet me fushatën e zgjedhjeve, siç janë:
 - 1.1. Mbajtja e takimeve për qëllime të fushatës së zgjedhjeve;
 - 1.2. shpërndarja ose ekspozimi i çfarëdo materiali të fushatës zgjedhore në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të qendrës së votimit, duke përfshirë rrethojat;
 - 1.3. tubimi ose kërkimi i mbështetjes nga personat që hyjnë në qendrat e votimit për të votuar, në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të Qendrës së Votimit (QV);
 - 1.4. shfrytëzimi i megafonave ose i sistemeve të tjera të zërimit, për t'iu drejtuar publikut kudo qoftë në Kosovë, me qëllim të ndikimit në votues, ose organizimi i çfarëdo manifestimi, procesioni ose demonstate të natyrës politike, ose pjesëmarrja në të;
 - 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit në votues;
 - 1.6. mbajtja e kartelave të zgjedhjeve, distinktivëve ose e shenjave të tjera të zgjedhjeve nga anëtarët e Këshillit të Vendvotimit – KVV, vëzhguesit e akredituar ose votuesit në ditën e zgjedhjeve, që promovojnë një subjekt të caktuar politik.
2. Rezultatet e anketave të hulumtimit të opinionit publik ose analizat në lidhje me qëllimet e votimit të zgjedhësve në zgjedhje, nuk duhet të publikohen ose t'i kumtohen publikut gjatë kësaj periudhe, duke filluar 24 orë para hapjes së vendvotimeve (VV) deri në mbylljen e VV.

Neni 7

Sanksionet

Përveç përgjegjësisë individuale për cenimin e cilësdo dispozitë të kësaj Rregulloreje, që është e ndëshkueshme me Kodin Penal të Kosovës, cenimet gjithashtu mund t'i referohen PZAP. PZAP mund t'i shqiptojë sanksione subjektit politik ose kandidatit që ka shkelur dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla zgjedhore nr.13/2013 fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike dhe Rregulla zgjedhore nr. 20/2019 ndryshim plotësim të Rregullës zgjedhore nr.13/2013.
2. Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore është shtojca I - Formulari për tubime publike.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi